# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-457170**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | E rëndë në Spanjë, 25-vjeçari fsheh në dollap trupin e babait të vdekur për 18 muaj, për t'i marrë pensionin |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/kronika/e-rende-ne-spanje-25-vjecari-fsheh-ne-dollap-trupin-e-babait-te-vdekur-p-i587034` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 09:20:02 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 09:45:05 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `e983b9fce00624d9b00a19e202232b52cb71b936d9a6921637a0c28206f43bbb` |
| TEKSTI | `3d74645725822ffa665d2e8a78658f9d923ec95a35acf1d164e5ecf8d2bf0df8` |
| PAMJA | `2e56ac2d1429b039f639d0e8822d7a3bf166c8c62c893779abece0c9d1540cb4` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `3fb4839909342692e5c6f50cc17fff71bc11ff641a11f6ec76742004afad0a2f` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/3fb4839909342692e5c6f50cc17fff71bc11ff641a11f6ec76742004afad0a2f`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

English



# E rëndë në Spanjë, 25-vjeçari fsheh në dollap trupin e babait të vdekur për 18 muaj, për t'i marrë pensionin

TemA
19 Shtator 2026, 11:45Kronika TEMA



Një 25-vjeçar spanjoll është arrestuar pasi mbajti të fshehur trupin e pajetë të babait të tij në dollapin e shtëpisë për të paktën 18 muaj, me qëllim që të vazhdonte të merrte pensionin e tij.

Ngjarja e rëndë u zbulua të enjten në qytetin e vogël Torrecaballeros, në Spanjë, pasi policia u alarmua nga një erë e rëndë që vinte nga banesa në rrugën Los Fresnos.

Kur hynë në shtëpi, efektivët gjetën trupin e 71-vjeçarit të mbështjellë me qese silikoni, në një përpjekje për të maskuar erën e dekompozimit. Edhe dhoma ishte izoluar me silikon për të parandaluar përhapjen e erës.

Sipas policisë, babai kishte ndërruar jetë rreth një vit e gjysmë më parë. I riu mund të përballet me akuza për fshehjen e trupit dhe për përfitimin në mënyrë të paligjshme të pensionit të të atit.

Ende nuk dihet shkaku i vdekjes. Ekspertiza mjeko-ligjore pritet të përcaktojë nëse 71-vjeçari ka vdekur nga shkaqe natyrore. Deri tani nuk janë raportuar shenja dhune dhe hetuesit dyshojnë se vdekja mund të ketë ardhur për shkaqe natyrore.

Ngjarja ka tronditur banorët e qytetit. Fqinjët e përshkruajnë të ndjerin si një person të shoqërueshëm, i cili frekuentonte rregullisht një lokal në zonë. Sipas tyre, ai vuante nga demenca dhe marrëdhënia me të birin dukej normale.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Vdekja pas lindjes e ish-bashkëshortes së futbollistit Alban Hoxha, Gjykata e Lartë rrëzon rekursin e 2 mjekëve

10:55 Kronika

Sekuestrohen mbi 400 kilogramë kanabis në frigorifer, arrestohet i riu shqiptar në Itali

10:18 Kronika

[Foto/ Tragjike në Greqi, si humbën jetën tre të rinjtë shqiptarë, nga aksidenti edhe dy të tjerë në gjendje kritike]

21:00 Kronika

[E rëndë në Itali/ Po shoqëronte vajzën për në shkollë, 42-vjeçarja shqiptare përplaset për vdekje nga kamioni]

18:30 Kronika

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.